



KONTRATË

Titulli i tenderit: Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik

Numëri i prokurimit: 636-23-10293-1-3-6

Numëri i brendshëm: 636-23-044-136

Numri i kontratës¹: 636-23-10293-1-3-6/C191

Data: 27.11.2023



KOMUNA E JUNIKUT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), përfaqësuar nga Z.Udhëheqësit të Prokurimit- Florinda Kukalaj në njërën anë,

dhe Operatori Ekonomik "BIOTEK KOSOVO" L.L.C., Rr.Vicianum Nr.300, Prishtine, me numër të biznesit, 810800161, (në vazhdim "Ofruesi i Punëve"), përfaqësuar nga Drejtori- Dejan Sinadinov, numri kontaktues: 045- 399- 159 dhe email-i: info@biotek-kosovo.com në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë: Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik me numër identifikues: 636-23-10293-1-3-6.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Numrues Elektronik te elemeneve te gjakut . - Ekran me prekje 10.1" me ngjyra. Aparat hematologjik me 21 parametra dhe 60 test gjithashtu me 3 sisteme. Metoda e rezistencës elektrike me dy kanale për numërimin e qelizave - Metoda kolorimetrike për përcaktimin e HGB - Vëllimi i ulët i mostrës, konsumi i ulët i reagentit - Modaliteti i holluar paraprakisht 20ul/test -Gjaku venoz ≤9.8ul gjak i plotë i paraholluar ≤20ul. - Printer termik i integruar -Ruatja e dhenave deri 200,000 analiza -Te kete USB port -Te jete prodhim BE (Aparati te jetë me opcion te hapur per reagensa). -Koha e liferimim 15 dita pas nenshkrimit te kontrates.	copë	1	4,000.00	4,000.00
Gjithsej totali me TVSH					4,000.000

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 27.11.2023 dhe përfundon me 27.12.2023.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë QKMF- Junik

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar). Neni 2 Çmimi

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: 4,000.00 €; Dhe me fjalë, Katërmijë euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore Pejë, Dega në Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Junik

Për Operatorin Ekonomik
"BIOTEK KOSOVO" L.L.C.

Emri:	Florinda Kukalaj	Emri:	Dejan Sinadinov
Pozita:	Z. Udhëheqësit të Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.11.2023	Data:	27.11.2023
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Numri i Prokurimit: 636-23-10293-1-3-6 – Titulli: Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF-në Junik

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [BIOTEK KOSOVO L.L.C] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	BIOTEK KOSOVO L.L.C
Adresa e plotë:	Rr.: Vicianum", Nr.300, Arberia, Prishtine
Përfaqësuar nga:	
Emri	Dejan Sindainov
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	10.10.2023
Vula	



Deklarate

Nga :	BIOTEK KOSOVO L.L.C Prishtine
Te :	KOMUNA E JUNIKUT
Data :	10.10.2023
Subjekti :	Nr.i prokurimit: "636-23-10293-1-3-6". Titulli: " Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik"

Ne Biotek Kosovo L.L.C me adrese: Rr."Vicianum", nr.300, Arberi, Prishtine,
nr.tel:00383/45399159 dhe me email: info@biotek-kosovo.com, per ofertën tonë në
këtë aktivitet të prokurimit deklarojmë se:

Deklarojme se pajisja e ofruar do te jete me garancion prej 2 viteve, ne baze te
kerkeses suaj ne dosie te tenderit.

Me respekt,

Biotek Kosovo L.L.C



Deklarate

Nga :	BIOTEK KOSOVO L.L.C Prishtine
Te :	KOMUNA E JUNIKUT
Data :	10.10.2023
Subjekti :	Nr.i prokurimit: "636-23-10293-1-3-6". Titulli: " Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik"

Ne Biotek Kosovo L.L.C me adrese: Rr."Vicianum", nr.300, Arberi, Prishtine,
nr.tel:00383/45399159 dhe me email: info@biotek-kosovo.com, per ofertën tonë në
këtë aktivitet të prokurimit deklarojmë se:

Deklarojme se liferimi i pajisjes do te behet 15 dite pas nenshkrimit te kontrates, ne
baze te kerkeses suaj ne dosie te tenderit.

Me respekt,

Biotek Kosovo L.L.C



Deklarate

Nga :	BIOTEK KOSOVO L.L.C Prishtine
Te :	KOMUNA E JUNIKUT
Data :	10.10.2023
Subjekti :	Nr.i prokurimit: "636-23-10293-1-3-6". Titulli: "Furnizim me paisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik"

Ne Biotek Kosovo L.L.C me adrese: Rr."Vicianum", nr.300, Arberi, Prishtine,
nr.tel:00383/45399159 dhe me email: info@biotek-kosovo.com, per ofertën tonë në
këtë aktivitet të prokurimit deklarojmë se:

Jemi ne perputhshmeri te plote me te gjithë specifikacionet teknike per mallrat e
ofruara ne baze te dosies se tenderit.

Me respekt,

Biotek Kosovo L.L.C



Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Numruar Elektronik te elemeneve te gjakut . - Ekran me prekje 10.1" me ngjyra. Aparat hematologjik me 21 parametra dhe 60 test gjithashtu me 3 sisteme. Metoda e rezistencës elektrike me dy kanale për numërimin e qelizave - Metoda kolorimetrike për përcaktimin e HGB - Vëllimi i ulët i mostrës, konsumi i ulët i reagentit - Modaliteti i holluar paraprakisht 20ul/test -Gjaku venoz ≤9.8ul gjak i plotë i paraholluar ≤20ul. - Printer termik i integruar -Ruatja e dhenave deri 200,000 analiza -Te kete USB port -Te jete prodhim BE (Aparati te jetë me opcion te hapur per reagensa). -Koha e liferimim 15 dita pas nenshkrimit te kontrates.	copë	1	4,000.00	4,000.00
Gjithsej totali me TVSH					4,000.00



Prokurimi: 636-23-10293-1-3-6

Nr i brendshëm:

Tituli: Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik

1 Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik

Kodi i tenderit: 101623

Data: 16.10.2023

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	CE Certificate.pdf
2.	Certifikata e biznesit..pdf
3.	Deklarata nen betim.pdf
4.	Deklarata per garancion.pdf
5.	Deklarata per liferim.pdf
6.	Deklarata per specifikacion teknik.pdf
7.	Identifikimi financiar.pdf
8.	Katalog.pdf
9.	Lista e kontratave dhe referencave.zip
10.	Pershkrimi i cmimit.pdf
11.	Qarkullimi bankar.pdf
12.	Vertetim nga Gjykata.pdf
13.	Vertetimi Tatimor.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik	Pershkrimi i cmimit.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E JUNIKUT, Qender, 51050, Junik,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 636-23-10293-1-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: "BIOTEK KOSOVO " L.L.C., Rr.Vicianum Nr.300, 10000, Prishtine, Kosovë

E-mail: info@biotek-kosovo.com

Personi kontaktues: Liridona Beadini

Telefoni: 00383/45399159

Faxi:

Numri fiskal: 810800161

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 636-23-10293-1-3-6

Titulli i kontratës: Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik

3. Çmimi total i tenderit është:

4,000.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Thëksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)